



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SHKUMBIN

Nr. Serial 000232

AUTORIZIM
PËR VEPRIMTARI TË TJERA NË BRIGJE DHE NË SHTRATIN E BURIMIT
UJOR

Nr. 164 Prot., datë 18 / 2 /2026

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TE BASENIT LUMOR SHKUMBIN

Nr.3, datë 11.02.2026

Emri i individit/subjektit: **"BASHKIA ELBASAN"**

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): **K52905207B**

Baseni Lumor: **SHKUMBIN**

Kodi Trupit Ujor:

Qarku: **ELBASAN**

Bashkia/ Njësia administrative: **BASHKIA ELBASAN**

Koordinatat:

1. X=492344.36; Y=4555241.36; Z=702
2. X=492360.32; Y=4555241.94; Z=702
3. X=492366.35; Y=4555210.03; Z=702
4. X=492346.46; Y=4555208.35; Z=702

Lloji i burimit ujor ku do të kryhet veprimtaria: **Përroi Gorre**

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: **Ndërtimi i këmbëve të urës dhe speronave tip Bel**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Sipas Vendimit dhe Kushteve të Posacme të Autorizimit**

Periudha e vlefshmërisë: **Nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren, në çdo rast jo më shumë se 2 (dy) vjet.**

Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.**

KRYETAR
ILIR BEJTJA



Kushtet e posacme te autorizimit per veprimtari te tjera ne brigje dhe shtratin e burimit uxor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë autorizimi;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen (kur është e aplikueshme);
5. Të regjistrojë vëllimin e materialit të zhvendosur, ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer;
6. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
7. Autorizimi nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit.
9. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit uxor;
10. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit uxor;
11. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
12. Të lejojë rrjedhjen ekologjike të miratuar.
13. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin uxor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
14. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin uxor në gjendjen e mëparshme;
15. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
16. Të sigurojnë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit uxor nga subjekte të tjerë;
17. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujore.